



Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered	20-04-2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTK	1910/2021		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.234/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-anëtare, dhe Zyle Millaku Gojnovci Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.2278/2019 të datës 29.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesës e datës 04.07.2019 me numër Anr.376/2019, së ankueses me adresë: Rr. "Fatmir Ibishi", Nr.3/35 në Komunë të Gjilanit, kundër organit të punësimit Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 20.04.2021, mori këtë;

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.376/2019 e datës 04.07.2019 e parashtruar nga ankueses

II. MBETET në fuqi Vendimi numër 02Nr.016-61520 i datës 03.06.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjilanit.

A r s y c t i m

Komuna e Gjilanit me datë 06.03.2019 ka shpallur konkursin për pozitën "Zyrtar për protokoll", në bazë të autorizimit të datës 04.03.2019 për shpallje të konkursit, lëshuar nga Ministria e Administratës Publike/ Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil, të cilin konkurs përmes njoftimit të datës 23.03.2019 e ka vazhduar edhe për shtatë (7) ditë kalendarike. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit (testin me shkrim dhe me gojë) por që nuk është përzgjedhur si kandidate e suksesshëm në këtë pozitë.

Komuna e Gjilanit më datë 21.05.2019 ka publikuar njoftimin me numër 02 Nr. 016/56093 për kandidatin e suksesshëm, ndërsa ankuesja kundër këtij njoftimi më datë 03.06.2019 ka

parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Gjilanit, i cili me datë 17.06.2019 ka nxjerr Vendim me numër 02Nr.016-61520 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses duke lënë në fuqi shpalljen e publikimit të rezultateve.

Ankuesja kundër Vendimit me numër 02Nr.016-61520 të datës 17.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Gjilanit, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.03/2016 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.07.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3014/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 18.07.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Gjilanit, ndërsa me datën 25.07.2019 me numër protokoll 3306/2019 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë Komuna e Gjilanit, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin A.nr.2278/2019 të datës 29.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë /Departamenti për Çështje Administrative,; Ankesën me numër protokoll 3014/2019 e datës 04.07.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me 02Nr.016-61520 i datës 17.06.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjilanit; Lista e kandidatëve; Konkursi i datës 06.03.2019, Formulari Form. MAP/SHCK-09 për Përmbledhjen e Vlerësimeve Individuale; Vendimi për aprovimin e raportit final i datës 20.05.2019; autorizimi i lëshuar nga DASHC/MAP i datës 04.03.2019; Njoftimi për zgjatjen e afatit për pranimin e aplikacioneve; Vendimi për themelimin e komisionit përzgjedhës ; Formulari për kërkesë apo i ankesë; Formulari i Aplikimit i datës 15.03.2019

Raporti final i listës se ngushtë i datës 04.04.2019; Testi me shkrim i datës 10.04.2019;; Formulari Form.MAP-SHCK-08a për Vlerësimin individuale i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formulari Form.MAP-SHCK-04 për regjistrin e Aplikacioneve të pranuar; Formulari Form.MAP-SHCK-05 përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e shkurtë;; Njoftimi i mbajtjes së datës me shkrim; Testi me shkrim i kandidatit të përzgjedhur i datës 10.04.2019; Testi me shkrim i ankuesit i datës 10.04.2019; Raporti i datës 24.04.2019 për vlerësimi ;Njoftimi për mbajtjen e intervistës me gojë; Formulari Form MAP-SHCK-09 për Përmbledhjen Individuale të vlerësimeve; Formulari Form MAP-SHCK-10 për Renditjen përfundimtare të kandidatëve; Formulari Form.MAP-SHCK-11 i Raportit Final të Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues; Vendimi Kryetarit të Komunës i datës 20.05.2019 me numër Prot: 02 Nr.353; Njoftimi për kandidatin e suksesshëm i datës 20.05.2019; Ftesa për Seancë dëgjimore e datës 12.06.2019 e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Procesverbali i datës 17.06.2019; Procesverbali për konsultim dhe votim i datës 17.06.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se kandidatja e përzgjedhur ka qenë në marrëdhënie të punës në kontratë mbi vepër për të cilën dyshon se e ka përpiluar edhe testin me shkrim dhe se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me ligjin.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses gjatë administrimit të provave konstaton se procedurës së rekrutimit, për të cilën dyshon ankuesja që është zhvilluar në kundërshtim me ligjin, lidhur me këtë pretendim të ankueses, Kolegji konstaton se janë të pa qëndrueshme lidhur me faktin se ankuesja nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me dyshimet e saja, për zhvillimin e procedurës së rekrutimit dhe si të tilla janë të pa argumentuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komuna e Gjilanit me datë 06.03.2019 ka shpallur konkursin për pozitën "Zyrtar për protokoll", kriteret e konkursit kanë qenë : **Diplomë Universiteti: bacheler i ekonomisë, juridikut, administratë publike pa përvojë punë ose SHL-së së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën përkatëse teknike ose administrative.**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Kryearti i Komunës së Gjilanit ka themeluar komisionin përzgjedhës, me datë 20.03.2019 duke nxjerrë Vendimin me nr.200, në pajtim me nenin 7 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku është e përcaktuar se: **"Institucionet themelojnë një Komision përzgjedhës ad Hoc të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim : KPSHC), i cili zhvillon procedurat e rekrutimit. KPSHCK përbëhet nga anëtarët të cilët kanë pozita më të larta, se pozita që duhet të rekrutohen, por një anëtar mund të ketë pozitën e njëjtë, të jetë shumetnik dhe me përfaqësim gjinor, KPSHC, zhvillon procedurat e rekrutimit për pozitën e karrierës dhe të jo karrierës",** i cili ka përgjegjësi të plotë në bazë të nenit 18 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përgjegjësi për hartimin e testit me shkrim dhe pyetjeve me gojë, në pajtim me dispozitat ligjor të nenit 33 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil , ka ku përcaktohet se: **"KPSHC përgatit testin me shkrim dhe vendos për pyetjet, të cilat do t'ju parashtrohen kandidateve në testim me gojë "**.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni përzgjedhës ka përfshirë në listën e ngushtë ankuesen dhe kandidaten e përzgjedhur, duke vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil i cili përcakton se: **"Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijim: elementet e tjera të meritës",** andaj mbi këtë bazë është konstatuar se në shërbimin civil, përzgjedhja e kandidatit nga procedura e rekrutimit bëhet në bazë të vlerësimit të komisionit përzgjedhës, për kandidatët që arrin pikë më shumë, nga vlerësimi i testit me shkrim dhe me gojë, që në rastin konkret komisioni përzgjedhës ka përzgjedhur kandidaten znj. e cila ka arritur gjithsej 86 pikët e përgjithshme, nga vlerësimi i testit me shkrim dhe me gojë, dhe është zgjedhur në pozitë: Zyrtare e protokollit", e cila posedon Diplomë me numër 466/1214, nga studimet themelore të përfunduara me datë 10.10.2013, dhe mori titullin Bachelor i Arteve në Banka, Financa dhe Kontabilitetit, nga Kolegji Fama (Institucion i Arsimit Universitar). Kurse ankuesja ka arritur gjithsej 70 pikët e përgjithshme nga testit me shkrim dhe me gojë, e cila ka Diplomë me numër



1417, nga studimet themelore të përfunduara me datë 25.04.2011, dhe mori titullin Baçelor i drejtësisë, lëshuar nga Fakulteti juridik –Universiteti i Prishtinës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në të gjitha të lartcekurat, konstaton se procedura e rekrutimit shpallur nga Komuna e Gjilanit për pozitën “Zyrtar për protokoll”, është zhvilluar në pajtim me dispozitat e nenit 18 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton që: **“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”** dispozitat të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjilanit, ka mbajtur seancë dëgjimore me datë 17.06.2019, lidhur me ankesën e ankueses të datë 03.06.2019, dhe mbi këtë bazë ka nxjerrje Vendimin me 02Nr.016-61520 të datës 17.06.2019 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses, duke vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si duke marr parasysh shkeljet e lartcekura, pa u lëshuar në shqyrtimin e shkeljeve tjera eventuale, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.234/2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
Gjykatës Themelore Prishtinë, Gjyqtarit Hajriz Hoti
- Kryetari i Komunës së Gjilanit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit;
- Arkivit të KPMSHCK-se

